

Instituti GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Gjilanit 2013

Maj 2013

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale tri vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuëse (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Hyrje.....	5
2. Problemet në Komunën e Gjilanit.....	6
3. Performanca buxhetore e Komunës së Gjilanit.....	7
4. Investimet kapitale.....	14
5. Aktivitetet e Prokurimit Publik.....	16
6. Administrata e Komunës së Gjilanit.....	19
7. Arsimi në Komunën e Gjilanit.....	22
8. Transparenca dhe informimi rreth aktiviteteteve të Komunës së Gjilanit.....	23
9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009.....	25
10. Burimet.....	29

Përmbledhje ekzekutive

Që nga zgjedhjet e para lokale në vitin 2000, Gjilani konsiderohej si bastion i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Por pas zgjedhjeve lokale të vitit 2007, komuna e Gjilanit për herë të parë hyri nën qeverisjen e PDK dhe kryetarit Qemajl Mustafa. Z.Mustafa fitoi edhe zgjedhjet lokale të 2009 për një mandat të dytë qeverisës katër vjeçar.

Gjatë fushatës zgjedhore të 2009, një nga reklamat më të përsëritura të z.Qemajl Mustafa ishte ajo e cila i ftonte qytetarët e Gjilanit që të “fotografoheshin duke pasur në prapavijë Gjilanin dhe për ta ruajtur kujtim, ngase për katër vite Gjilani do të marr krejt pamje tjetër.” Mirëpo, pas afro katër viteve të qeverisjes në mandatin e dytë, pamja e Gjilanit është ajo e katër viteve më parë.

Pak muaj pas marrjes së mandatit të dytë, Qemajl Mustafa paralajmëron dorëheqje nga posti me arsyetimin se nuk i ka duart e lira për të qeverisur. Ai me këtë ka akuzuar subjektin e tij PDK se ka zgjedhur drejtorët komunalë me imponim, pa e pyetur atë për profilin e tyre. Një muaj pas kësaj, në prill 2010, z. Mustafa paralajmëron sërish dorëheqje, kësaj radhe me arsyetimin se niveli qendror i qeverisjes nuk po e mbështet financiarisht për t’i përmbushur objektivat e parapara zgjedhore. Edhe për kundër këtyre paralajmërimeve, Mustafa nuk u tërhoq nga pozita e të parit të komunës, por vetëm nga Kryesia e PDK-së në Gjilan.

Kryetari Mustafa është një ndër kryetarët më të përfolur për përzierjet e tij në procedurat e prokurimit dhe lidhjet e tij me bizneset komunale. Qemajl Mustafa, para marrjes së postit të Kryetarit të Komunës, ishte një biznesmen i suksesshëm. Lidhjet e tij formale dhe joformale me bizneset vazhduan edhe pas zgjedhjes së tij si kryetar, disa herë duke rënë ndesh edhe me ligjet në fuqi. Për shkak të këtyre lidhjeve, më 30 maj 2012, Gjykata për Kundërvajtje në Gjilan ka dënua Qemajl Mustafën me 700 euro për shkak të konfliktit të interesit.

Administrata komunale e Gjilanit është e mbingarkuar me staf. Për shkak të kësaj, në gusht të 2011, Ministria e Financave nuk kishte lëshuar pagesat për rrogat e stafit të administratës së Gjilanit për më shumë se një javë. Përveç mbingarkesës së stafit administrativ, Komuna e Gjilanit për këto tri vite të qeverisjes ka punësuar së paku 38 punonjës me kontratë mbi vepër, pagat e të cilëve nuk figurojnë në listën e pagave por paguhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Komuna e Gjilanit ka angazhuar individë me kontratë mbi vepër për periudha më shumë se tre vjeçare. Për këto pozita nuk ka pasur konkurs të shpallur. Në këtë formë është punësuar edhe gruaja e vëllait të Kryetarit Mustafa, si Zyrtare e Personelit në kuadër të Zyrës së Kryetarit. Kryetari Qemajl Mustafa është kujdesur që të punësojë edhe gruan e tij në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, çfarë ka ngjallur reagime publike të partive opozitare dhe mediave. Përveç në

administratë, punësimet në baza familjare dhe partiake janë hasur gjerësisht edhe në sferën e arsimit.

Edhe pse udhëheq me Komunën e Gjilanit, Kryetari Mustafa me banim të përhershëm ndodhet në Prishtinë. Përveç se kjo bie ndesh me Statutin e Komunës dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, banimi në një komunë tjetër ka krijuar edhe shpenzime shtesë në karburante, ngase përshkrimi i rrugës Prishtinë-Gjilan dhe anasjelltas bëhet me veturën zyrtare të Komunës. Për tri vite, vetëm vetura e kryetarit të Komunës ka shpenzuar 15.186,6 litra karburante, apo shprehur në vlerë monetare, janë shpenzuar 18.527 Euro. Gjersa e tërë Komuna e Gjilanit për tri vite ka shpenzuar 434.964 euro për karburante për vetura. Shpenzime të mëdha janë bërë edhe në kategorinë e drekave zyrtare (296.277 euro për tri vite), udhëtime dhe mëditje jashtë vendit (144.335 euro për tri vite), etj.

Gjilani ka përmbyllur vitin 2012, duke u kategorizuar si komuna me shkallën më të lartë të borxhit publik, me rënien e nivelit të të hyrave komunale dhe me rritjen e shpenzimeve në kategoritë e mallrave dhe shërbimeve.

Gjatë fushatës zgjedhore të 2009, z.Mustafa kishte premtuar së paku realizimin e 25 projekteve të ndryshme. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas tri viteve të qeverisjes në Komunën e Gjilanit, 8 premtime janë përmbushur, 12 tjera nuk janë përmbushur, ndërsa në 5 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen akoma premtime të përmbushura.

1. Hyrje

Kryetari i Komunës së Gjilanit z. Qemajl Mustafa për të udhëhequr me Gjilanin është detyruar të futet në koalicion të gjerë me subjektet tjera politike me qëllim për të fituar votat e mjaftueshme në Kuvendin Komunal. Qeverisja e PDK-së në Gjilan ndahet me AKR, PD, PSDK dhe KDTP.

Qemajl Mustafa në zgjedhjet e fundit lokale të mbajtura në fund të vitit 2009 ka fituar nëpërmjet balotazhit mes tij dhe kundër kandidatit nga subjekti politik LDK, Fatmir Rexhepi, i cili në raundin e dytë ka marr 48.6% të votave, kundrejt Qemajl Mustafës i cili ka dal me 51.4%.

Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Gjilani ka rezultuar t'i ketë 90.178 banorë. Kësisoj, kjo komunë radhitet e pesta në vend për nga numri i popullsisë, pas Prishtinës, Prizrenit, Ferizajt dhe Gjakovës.¹ Numri i banorëve nga regjistrimi i popullsisë përkon me pritjet dhe supozimet që kanë pasur autoritetet e Gjilanit në lidhje me këtë shifër.² Megjithatë, Gjilani vazhdon të marr grant nga niveli qendror për 100.348 banorë.³ Në të ardhmen kur Qeveria e Kosovës do t'u referohet numrit të banorëve për grante nga regjistrimi i fundit i popullsisë, Komunës së Gjilanit do t'i zvogëlohet buxheti deri në 633.000 euro.⁴

Kuvendi Komunal i Gjilanit i ka 41 asambleistë. PDK nga zgjedhjet lokale ka arritur të fitojë 14 ulëse, kurse LDK ka 10 ulëse, AAK ka pesë ulëse, AKR dhe LDD i kanë nga katër ulëse, ndërsa me nga një ulëse janë përfaqësuar edhe PD, ORA, KDTP si dhe PSD.⁵ Pas koalicionit në mes PDK dhe AKR-PD-PSDK-KDTP, PDK llogarit në 21 vota në Kuvendin komunal. Ndryshime ka pasur edhe në subjektet tjera të përfaqësuar në Kuvendin Komunal të Gjilanit. Kësisoj, partia ORA, përfaqësuesi i saj në Kuvend i është bashkangjitur LDK, së bashku me dy asambleistë të LDD-së, duke e rritur këtë subjekt politik në Kuvendin e Gjilanit në 13 asambleistë.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Komuna e Gjilanit. Faqja Zyrtare. Gjeografia dhe demografia. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/gjilan/City-guide/Geography.aspx>

³ Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Fq 22. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf

⁴ Instituti për Studime të Avancuara GAP. Regjistrimi i Popullsisë dhe ndikimi në politikën publike. Fq 4. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/67092_GAPanalizepertedhenateASK.pdf

⁵ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet përfundimtare për Kuvendet komunale nga zgjedhjet lokale të vitit 2009. Fq 5. Komuna e Gjilanit. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/komune/ResultsByMunicipality.pdf>

2. Problemet në Komunën e Gjilanit

Qytetarët e Komunës së Gjilanit përveç problemit të papunësisë dhe mos zhvillimit ekonomik, përballen edhe me probleme të cilat ekskluzivisht janë të lidhura me qeverisjen lokale. Kësisoj, gjatë mandatit të dytë të Qemajl Mustafës, nuk është arritur të zgjidhen problemet nga mungesa e ujit të pijes. Shumë zona përballen nga mungesa e kanalizimeve kurse në disa zona tjera kanalizimet janë jo funksionale, shkak i mos mirëmbajtjes së tyre. Në shumicën e zonave rurale mungon asfaltimi i rrugëve dhe kushtet në objektet arsimore nuk i përmbushin kriteret. Probleme për banorët konsiderohen edhe mos mirëmbajtja e duhur e tregut të gjelbër, mos mirëmbajtja e ndërtesave të vjetra në qytet, mungesa e shportave nëpër qytet për hedhjen e mbeturinave të imta, mungesa e ndriçimit publik në shumë zona të qytetit si dhe ndërtimet pa leje dhe jashtë standardeve urbanistike. Njëherazi, problematike vazhdon të konsiderohet dëmtimi dhe vjedhja e shenjave të komunikacionit, dëmtimi i ulëseve për qytetarët, uzurpimi i hapësirave publike, dëmtimi parqeve dhe pyjeve, mungesa e kushteve për ofrimin e shërbimeve në shëndetësinë primare, tjetërsimi i tokës bujqësore dhe transferimi i saj në tokë ndërtimore. Si problem i pazgjidhur ka vazhduar të mbetet shtrati i lumit Stanishor i cili kundërmon gjatë sezonit të verës.

Investimet e Komunës së Gjilanit në rregullimin dhe zgjerimin e kanalizimeve gjatë tri viteve të fundit kanë rezultuar të jenë të pamjaftueshme për të zgjidhur këtë problem. Kjo komunë ka shumë zona të cilat janë pa kanalizim të rregulluar, si fshatrat Bresalc, Cernicë, Livoç, Uglar, Ponosh, Zhegoc, Zheger. Gjithashtu, pa kanalizim është zona periferike e qytetit që shpie në drejtim të fshatit Malishevë. Problem me kanalizime në Gjilan kanë edhe zonat që formalisht konsiderohen të kenë të instaluar gypat përkatës të kanalizimeve. Banorët përgjatë rrugëve “Reshat Ymeri”, “Abdullah Presheva”, “Dëshmorët e Kombit” dhe “Adem Jashari” të cilat ndodhen në qendër të qytetit disa herë radhazi i kanë adresuar shqetësimet e tyre nga bllokimi i shpeshtë i kanalizimeve. I njëjti problem haset edhe në disa zona tjera të qytetit.

Ndërtesat e vjetra në qytetin e Gjilanit të cilat shtrihen në zonat e qendrës ofrojnë pamje jo të mirë për qytetin. Në to vërehet mungesa e dyerve të hyrjes, mungesa e dritareve nëpër shkallët e ndërtesës, korridoret e brendshme të ndërtesave nuk kanë ndriçim elektrik gjatë natës, mungesa e ashensorëve si dhe mungesa e shkallëve për dalje të mundshme emergjente. Banesat nuk kanë harmonizim linear, disa i kanë shndërruar ballkonet në hapësirë të banimit e disa të tjerë në hapësirë për dedikimin e gjëseneve, duke atakuar kësisoj pamjen e përgjithshme të qytetit.

Gjilani në tri vitet e fundit është mbërthyer nga nisja e ndërtimeve të larta të banimit dhe afarizmit. Në asnjë rast nuk është hasur në brendi të qytetit të jenë nisur ndërtimet e tilla duke parashikuar dhe dedikuar hapësirë për gjelbërim dhe kënde rekreative për fëmijë.


Dukuria e tjetërsimit të tokës bujqësore dhe transferimi i saj në tokë ndërtimore në Komunën e Gjilanit në tri vitet e fundit ka marr përmasa të gjera. Kjo vërehet në të gjitha zonat përreth qytetit të Gjilanit. Kjo dukuri nuk është ngritur për trajtim asnjëherë nga ana e organeve kompetente. Krahas kësaj, uzurpimi i pronave dhe hapësirave publike dhe shfrytëzimi i tyre pa leje përkatëse përveç që dëmton buxhetin komunal, t'kurr hapësirën publike. Në muajin shkurt 2013, autoritetet komunale kanë përpiluar një listë ku figurojnë 120 lokacione të ndryshme në të cilat janë bërë uzurpime pronash publike.

Autoritetet komunale të Gjilanit janë treguar të pafuqishme për të ndryshuar formën e menaxhimit në deponinë e mbeturinave në Uglar. Nga kjo deponi kanë rrjedhur ujëra të ndotura që janë shpërndarë në burimet e ujit të pijes në fshat, nëpër ara të mbjella dhe në oborret e shtëpive të banorëve. Gjatë tri viteve të fundit është vërejtur në disa raste neglizhencë e theksuar e udhëheqëseve komunal për t'i adresuar disa probleme të cilat në mënyrë të vazhdueshme kanë shqetësuar banorët e disa zonave të Gjilanit. Shembull për këtë mund të merret rasti i ngritur nga ana e banorëve të fshatit Pogragjë të cilët kanë kërkuar nga komuna që t'i kontrollojë dhe limitojë aktivitetet e gurëthyeseve në këtë zonë. Po ashtu, banorët e Zhegrës tash e disa vjet kërkojnë ndërtimin e një ure.

3. Performanca buxhetore e Komunës së Gjilanit


Për tri vite, Komuna e Gjilanit ka shpenzuar buxhet prej 58.247.972,26 Euro, apo rreth 19 milion euro në vit. Edhe në vitin 2013, kjo komunë ka planifikuar të shpenzojë 18.4 milion euro buxhet. Për tërë mandatin qeverisës katërvjeçar, Komuna e Gjilanit ka në dispozicion afro 77 milion euro.

Grafikoni nr.1: Buxheti i Komunës së Gjilanit 2010-2013



Për këto katër vite, pjesa më e madhe e mjeteve janë shpenzuar për paga dhe mëditje të stafit administrativ, arsimor dhe shëndetësor (43.2 milion euro apo 56.3%). Pas pagave, vijnë investimet kapitale si kategori e dytë e shpenzimeve (19.6 milion euro apo 25.5%), etj.

Grafikoni nr.2: Trendi i shpenzimeve sipas kategorive 2010-2013



Siç mund të vërehet nga grafikoni nr.2, investimet kapitale kanë shkuar duke rënë gjatë viteve, kurse kategoria e pagave dhe ajo e mallrave dhe shërbimeve duke u rritur.

Të hyrat vetanake të Komunës së Gjilanit sillen rreth 3 milion euro në vit.

Tabela: nr.1: Të hyrat komunale në katër vitet e fundit në Komunën e Gjilanit

Viti	Plani 2013	2012	2011	2010	2009
Shuma (euro)	3.600.000	3.177.028	3.524.807	3.120.972	2.607.725

Të hyrat kanë qenë më të ulëta në 2012 se sa në 2011, por janë të të njëjtit nivel me të hyrat e 2010. Tabela më poshtë pasqyron të hyrat sipas kategorive.

Tabela: nr.2: Pasqyrimi i të hyrave komunale gjatë vitit 2012 sipas sektorëve dhe krahasimi i tyre me vitin 2011 dhe 2010

Linja e të hyrave	Shuma (euro)		
	2012	2011	2010
Të hyra nga administrata	184.598	156.785	178.392
Të hyra nga qiraja	47.624	37.686	37.066
Të hyra nga biznesi	289.231	306.040	241.198
Të hyra nga lejet e punës	56.746	3.564	7.445
Të hyra nga lejet e ndërtimit	575.648	674.909	451.678

Të hyra nga shërbimet publike	124.621	89.591	79.321
Të hyra nga gjeodezia	168.147	161.380	176.509
Të hyra nga Drejtoria e Kulturës	11.030	9.891	13.717
Të hyra nga regjistrimi i automjeteve	127.995	131.066	124.215
Të hyra nga Inspekcioni	34.093	44.649	40.250
Të hyra nga tatimi ne pronë	942.927	1,036.995	942.041
Të hyra nga gjobat në trafik dhe gjykatave	290.370	551.063	564.103
Të hyra nga Drejtoria e Bujqësisë	1.230	8.046	00
Të hyra nga Agjencia e pyjeve	9.864	5.118	12.038
Të hyra nga sektori i arsimit	188.816	192.851	178.220
Të hyra nga sektori i shëndetësisë	94.788	82.423	74.779
Të hyra nga koncesioni	29.300	32.250	00
Të hyra te tjera	00	500	00
Gjithsej	3.177.028	3.524.807	3.120.972

Komuna e Gjilanit duke u bazuar në iniciativën e Kryetarit së fundmi ka fuqizuar vendimin i cili i obligon shërbyesit civil dhe mësimdhënësit e kësaj komune të paguajnë tatimin në pronë, apo në të kundërtën, komuna do të ndërhyjë në pagesa duke u ndalur një shumë të caktuar nga paga.

Komuna e Gjilanit ka përmbyllur vitin 2012 me nivelin më të lartë të borxhit nga të gjitha komunat tjera të vendit. Hyrja në borxh ka ardhur si pasojë e kontraktimit të punëve dhe marrja e shërbimeve pa pasur të sigurt mbulimin financiar të tyre. Mbi 3.3 milionë euro vlerësohet të jetë vlera e borxhit që Komuna e Gjilanit u ka operatorëve të ndryshëm privat.⁶

Në bazë të raporteve zyrtare të Komunës së Gjilanit, hasen shifra të mëdha, në krahasim me komunat e tjera të shpenzimeve të parasë publike në linjën e mallrave dhe shërbimeve. Nga kjo linje, paguhen kategoria e darkave dhe drekave zyrtare, telefonave mobil, udhëtimeve brenda dhe jashtë vendit, mëditjeve, mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare, blerjes së automjeteve, blerjes së naftës për vetura, gjenerator dhe ngrohje, blerjes së druve dhe thëngjillit për institucionet arsimore dhe shëndetësore, furnizim me ushqim dhe pije, blerja e mobileve si dhe pajisjeve tjera. Krahasimi i shpenzimeve të buxhetit në linjën për mallra dhe shërbime në Komunën e Gjilanit në tri vitet e fundit, nxjerr në pah rritje të shpenzimeve nga viti në vit dhe pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë bërë nga Zyra e Kryetarit.

⁶ Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit. 31 dhjetor 2012. Fq 68.

Tabela nr.3: Vlerësimi i totalit të shpenzimeve gjatë tri viteve të fundit në disa kategori nga Komuna e Gjilanit

Kategoria	2010	2011	2012	Gjithsej
Dreka Zyrtare	102.620	116.423	77.234	296.277
Telefoni mobile	24.774	30.880	25.959	81.613
Telefoni fikse	51.360	43.799	37.891	133.050
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	35.456	57.091	51.788	144.335
Derivate për vetura	148.659	181.214	105.091	434.964
Derivate për gjenerator	8.936	11.737	12.951	33.624
Naftë për ngrohje	124.932	158.827	154.634	438.393
Blerje e telefonave	10.476	2.348	-	12.824
Blerje e kompjuterëve	24.718	15.042	4.808	44.568
Blerja e druve	154.928	123.087	157.643	435.658
Blerja e thëngjillit	14.119	14.481	-	28.600
Riparimi i automjeteve	60.840	37.558	41.179	139.577
Furnizim me ushqim dhe pije	124.925	89.938	102.048	316.911
Municion dhe armë zjarri	4.000	4.800	3.300	12.100
Reklama dhe konkurse	12.376	34.588	25.278	72.242
Botime e Publikime	11.547	16.707	16.895	45.149
Sigurimi fizik i ndërtesave	-	-	232.441	232.441
Mirëmbajtja e ndërtesave	43.202	51.856	35.751	130.809
Mirëmbajtja e objekteve shkollore	58.658	16.052	122.588	197.298
Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore	5.207	-	-	5.207
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	-	-	12.848	12.848
Mirëmbajtja e klimave dhe ngrohjes qendrore	-	-	16.869	16.869
Furnizim për zyre	236.222	234.374	-	470.596

Kryetari i Komunës, Qemajl Mustafa me banim të përhershëm është në Prishtinë. Ai udhëton për çdo ditë nga Prishtina për në Gjilan dhe anasjelltas, duke e shfrytëzuar automjetin zyrtar të Komunës. Kjo rritë shpenzimet për karburante të cilat mbulohen nga buxheti komunal. Edhe pse Qemajl Mustafa disa herë është arsyetuar se ai ka banesë edhe në Gjilan dhe jo gjithëherë udhëton nga Prishtina, në formularin për deklarimin e pasurisë ai ka deklaruar se ka vetëm një shtëpi.⁷ Për shkak të ndërrimit të vendbanimit, partitë politike opozitare kanë kërkuar nga Kuvendi Komunal që të shkarkojë z. Mustafa, duke u thirrur në nenin 77.2.d të Statutit të Komunës⁸ dhe nenit 2.3.c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale⁹, të cilat parashohin përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës nëse ai ndërron vendbanim në një komunë tjetër.

⁷ Agjencia Kund25ër Korrupsionit. Deklarimi i Pasurisë. Komuna e Gjilanit. Qemajl Mustafa. 2011. Burimi: http://akk-ks.org/2011/Komunat_e_Kosoves/Komuna_Gjilan/Qemajl_Mustafa.pdf

⁸ Komuna e Gjilanit. Statuti i Komunës së Gjilanit. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjilan/>

⁹ Kuvendi i Kosovës. Ligji për Vetëqeverisje lokale. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf

Vetura zyrtare e Kryetarit të Komunës z.Mustafa është prodhim i vitit 2010 i markës Mitsubishi Pajero. Sipas të dhënave të siguruara nga Instituti GAP, për tri vite (2010-2012) vetura zyrtare e Kryetarit të Komunës z. Mustafa ka shpenzuar 15.186,6 litra, apo sipas viteve: 4.584,08 litra janë shpenzuar më 2010, 5.202,56 më 2011 dhe 5.399,96 më 2012. Shprehur në vlerë monetare, vetura e Kryetarit të Komunës ka shpenzuar rreth 18.527 euro karburante, apo 4.2% të totalit të shpenzimeve për karburante për tri vite që i ka bërë Komuna e Gjilanit. Komuna e Gjilanit ka gjithsej 35 automjete zyrtare në përdorim.

Tabela nr.4: Automjetet zyrtare të Komunës së Gjilanit dhe numrat e tyre të regjistrimit

Nr.	Lloji i automjetit	Nr. i targës
1	Mitsubishi P.	06Z-01-04
2	Hyundai Santa Fe	06Z-02-04
3	Hyundai Santa Fe	06Z-04-04
4	Hyundai Tarracan	06-712-AP
5	Nissan	06-576-BC
6	Nissan Patrol	3Z-165-18
7	Peugeot	06-571-BC
8	Peugeot	06-572-BC
9	Peugeot	06-713-AP
10	Peugeot	06-714-AP
11	Peugeot	06-715-AP
12	Peugeot	06-891-BJ
13	Peugeot	06-717-AP
14	Toyota R.	06-790-AB
15	Toyota R.	06-801-AB
16	Kombi H.	06-679-AS
17	Kombi H.	06-697-BC
18	Polo	06Z-03-04
19	Polo	06-417-AS
20	Polo	06-862-AK
21	Caddy	06-724-AJ
22	Caddy	06-725-AJ
23	Mercedes	06-723-AJ
24	Niva	06-339-AM
25	Niva	06-568-BH
26	Kombi Fiat	06-565-AE
27	Ford Tranz.	01-610-CS
28	VË Kombi	06-718-AC
29	Ford Focus	06-646-BO
30	Mitsubishi P.	06-574-BC
31	Mitsubishi P.	06-667-AS
32	Nissan Patrol	06-477-BL
33	Minibus Toyota	3Z-136-09

34	Minibus Toyota	3Z-155-09
35	Polo	06-564-BH

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) në raportin e saj për Komunën e Gjilanit, gjen se në emër të Zyrës së Kryetarit, është paguar fatura për bileta aeroplani në shumë prej 4.975 euro për udhëtimin e një drejtori, dy arsimtarëve dhe 20 nxënësve në një festival të organizuar në Turqi. Përveç faturës së lëshuar nga furnitori “Altavia Travel,” nuk ekzistojnë dëshmi shtesë si p.sh. biletat e udhëtimit për pjesëmarrësit në këtë udhëtim. Përveç kësaj, në faturë në mesin e udhëtarëve figuron një pjesëmarrës që nuk është as nga nxënësit as nga personeli i shkollës pjesëmarrëse. Po ashtu Auditorit gjen që në emër të Zyrës së Kryetarit ishte paguar fatura për bileta aeroplani në shumë 5.555 euro për vizitë studimore në Turqi për studentë të Fakultetit të Edukimit. Për këtë shpenzim, ZAP-it nuk i është ofruar ndonjë projekt në bazë të cilit është bërë shpenzimi. Po ashtu, përveç faturës nga furnitori “AIRTOUR” nuk ekzistojnë dëshmi shtesë si p.sh. biletat e udhëtimit për pjesëmarrësit në këtë udhëtim. Madje edhe lista e pjesëmarrësve është e pa nënshkruar. Njëherazi në emër të Zyrës së Kryetarit ishte paguar fatura ndaj furnitorit “Ballkania” në shumë 5.250 euro për furnizim të familjeve skamnore me artikuj sanitar. Me këtë rast Auditori nuk ka gjetur dëshmi të nënshkruara nga familjet për llojin dhe sasinë e artikujve të pranuar.¹⁰

Pas deklarimit të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion (AKK) për 2012, AKK kishte vërtetuar se ekziston konflikt i interesit në ushtrimin funksionit publik, pasi që në bazë të të dhënave të Agjencionit të Regjistrimit të Bizneseve, Qemajl Mustafa ishte personi i vetëm i autorizuar i kompanisë “Fruta Viva”.¹¹ Më 30 maj 2012, Gjykata për Kundërvajtje në Gjilan ka dënuar Qemajl Mustafën me 700 euro për shkak të konfliktit të interesit.¹² Arsyetimi i Qemajl Mustafës ishte se ai nuk kishte deklaruar pronësinë në këtë kompani ngase kjo ishte kompani e shuar dhe nuk ushtronte asnjë aktivitet ekonomik. Mustafa nuk ka pranuar konstatimin e AKK dhe vendimin e Gjykatës për Kundërvajtje.

¹⁰ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Gjilanit për vitin 2011. Fq 16 & 17. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGL_2011_Shqip_115733.pdf

¹¹ Agjencia Kundër Korrupsionit. Deklarimi i Pasurisë. Komuna e Gjilanit. Qemajl Mustafa. 2012. Burimi: http://akk-ks.org/2012/Komunat/Komuna_e_Gjilanit/Qemajl_Mustafa.pdf

¹² Agjencia Kundër Korrupsionit. Vendimet për konflikt të interesit. Qemajl Mustafa. Vendim i nxjerr me 14.05.2012. Nr.03-1793/2012. Burimi: <http://akk-ks.org/repository/docs/03-1793-2012.pdf>

Tabela nr.5: Shpenzimet komunale 2010-2012

Kategoria	2012	2011	2010 ¹³
Pagesat për energji elektrike	271.675	270.978	293.330
Pagesat për ujë	47.579	54.195	111.797
Pagesat për mbeturina	22.439	25.881	42.275

Shikuar nga këndvështrimi i numrit të popullsisë, Komuna e Gjilanit është e përafërt me Komunën e Podujevës dhe Pejës.¹⁴ Krahasimi i shpenzimeve në disa kategori mes Komunës së Gjilanit dhe dy komunave të tjera rezulton se Gjilani shpenzon shumëfish më shumë në shumicën e kategorive buxhetore.

Tabela nr.6: Krahasimi i disa shpenzimeve të Komunës së Gjilanit me Komunën e Pejës dhe Podujevës për periudhën janar 2010 - dhjetor 2012

Komunat	Kategoria				
	Darka dhe dreka	Karburant për vetura	Telefona fiks dhe mobil	Mëditje udhëtime jashtë vendit	Riparimi i automjeteve
Komuna e Gjilanit	296.277	434.964	214.633	144.335	139.577
Komuna e Pejës	214.004	462.339	195.724	85.918	220.113
Komuna e Podujevës	28.803	262.170	106.810	16.677	67.283

Komuna e Gjilanit është e vetmja komunë në vend ku është hasur shpenzim i parasë publike për blerjen e armëve dhe municionit. Këto shpenzime janë bërë që nga viti 2010 nga Zyra e Kryetarit. Zyrtarët e Komunës së Gjilanit këto shpenzime i kanë arsyetuar me blerjen e fishekzjarrëve për festat e fund vitit si dhe për përvjetorët e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Kategorizimin e fishekzjarrëve të blerë përmes kodit për armë dhe municion, zyrtarët komunal të Gjilanit e kanë arsyetuar me mungesën e kodit të veçantë të ndarë nga Thesari për blerjen e fishekzjarrëve. Kjo bie ndesh me rregullat e Thesarit, sipas së cilave çdo organizatë buxhetore e cila për blerjet gjatë vitit nuk mund t'i klasifikojë në kodet aktuale të shpenzimeve, duhet të kërkojë me shkrim nga Thesari për të caktuar një kod të ri të blerjes.

¹³ Shpenzimet e vitit 2010 në kategorinë e shpenzimeve komunale përfshijnë edhe territorin e Komunës së Parteshit e cila në fillim të vitit 2011 është pavarësuar financiarisht nga Komuna e Gjilanit. Tabelat e mësipërme nuk kanë përfshirë shpenzimet e bëra në kategorinë e emërtuar 'Partesh'.

¹⁴ Gjilani nga regjistrimi i Popullsisë ka dalë t'i këtë 90.178 banorë, Podujeva 88.499 banorë, Peja 96.450 banorë, Gjakova 94.556 banorë. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

4. Investimet kapitale

Komuna e Gjilanit është në mesin e pak komunave të vendit e cila ka pasur rënie të buxhetit në linjën për investime kapitale. Më 2013, Komuna planifikon të investojë rreth 3 milion euro në projekte kapitale. Shuma e investimeve kapitale më 2011 ishte 5.5 milion euro. Projekti më i rëndësishëm dhe më i kushtueshëm kapital është ai i rregullimit të shtratit të lumit Mirusha, investim i Komunës së Gjilanit dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila ka ndarë rreth 1.4 milion euro.¹⁵ Rregullimi i shtratit të lumit ka qenë projekt shumëvjeçar, i cili është premtuar nga Kryetari Mustafa edhe në mandatin e tij të parë qeverisës më 2007. Përfundimi i këtij projekti do të zgjidh një nga problemet më të mëdha me të cilat janë përballur qytetarët e Gjilanit – kundërmimi nga ujërat e zeza të derdhuna në shtratin e lumit Mirusha.

Për tri vite, Komuna e Gjilanit ka investuar mbi 14 milionë euro në projekte kapitale, prej tyre 603.266 euro në objekte arsimore, vetëm 4.795 euro në objekte shëndetësore, 567.077 euro në objekte sportive, etj. Tabela në vijim pasqyron investimet kapitale të ndara sipas kategorive të investimeve.

Tabela nr.7: Investimet kapitale në Komunën e Gjilanit sipas fushave dhe vlerës së mjeteve financiare gjatë tri viteve.¹⁶

Fushat	2010	2011	2012
Investimet në ndërtesa të banimit	601.853	263.624	60.728
Investimet në ndërtesa administrative – afariste	102.833	87.377	33.882
Investimet në objektet arsimore	371.597	54.746	176.923
Investimet në objektet shëndetësore	4.795	00	00
Investimet në objektet kulturore	191.177	201.198	35.800
Investimet në objektet sportive	213.769	177.404	175.904
Investimet në ndërtimin e rrugëve lokale	2.687.101	1.717.888	1.576.561
Investimet për trotuar	548.317	673.126	589.481
Investimet për kanalizim	706.047	249.725	185.969
Investimet për ujësjellës	333.537	172.690	468.585
Shpronësim/kompensim	315.445	628.816	182.710
Ndreqim publik/ rregullimi i rrjetit elektrik	80.687	99.637	167.893
Gjithsej	6.157.158	4.326.231	3.654.436

¹⁵ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor. Departamenti i ujërave. Investimet. Burimi:

<http://mmph-rks.org/sq/Departamenti-i-Ujerve/304>

¹⁶ Tabela nr.13. Paraqet shumën e investuar në fushat përkatëse. Mos përputhja e shifrave mes investimeve kapitale në tabelën nr.13 dhe në tabelën nr.3: vije për shkak të kontraktimit të punëve pa pasur mbulim financiar, përkatësisht hyrjes në borxh nga ana e Komunës së Gjilanit.

Tabela nr. 8: Investimet më të mëdha të Komunës së Gjilanit 2010-2012

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2012	Shuma (euro)
Asfaltimi i rrugës në lagjen "Zabeli i Sait Agës"	94.970
Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Dardania", rruga "Vëllezërit Hyseni"	172.540
Rregullimi i ujësjellësit në fshatin Doberqan	110.000
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Livoq i Ulët	116.337
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Malishevë,, Lagjja e "Muhaxhirëve"	202.346
Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Arbëria"- ish tregu i kafshëve	100.000
Rregullimi i infrastrukturës publike në fshatin Shillovë	117.291
Rregullimi i Infrastrukturës së rrugës "Halim Orana" dhe "Fehmi Agani"	120.488
Asfaltimi i rrugës Kosaq - Kosaq e Epërme	40.770
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dobërqan	52.088
Investime infrastrukturore në Kishnapolë	26.000
Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011	Shuma (euro)
Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Reshat Ymer"	66.718
Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në rrugën "Vëllezërit Hyseni"	32.062
Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Arbëria" "Faza e III"	88.411
Ndërtimi i qendrës memoriale "Kodra e Dëshmorëve"	33.461
Rregullimi dhe zgjerimi i hapësirave gjelbëruese në lagjen "Iliria"	22.768
Ndërtimi i trotuarit përgjatë rrugës në fshatin Mireshe	17.768
Rregullimi i shesheve i infrastrukturës publike në fshatin Shillovë	27.972
Punimi i kanalizimit të ujërave atmosferik në rrugën "Jugë 1"	24.040
Rregullimi i shtratit të lumit Bejta	216.740
Punë shtesë në rregullimin e lumit Mirusha	121.037
Gëlqerosja e objekteve banesore në lagjen "Iliria"	10.985
Asfaltimi i rrugës në lagjen "Malësia"	314.399
Rregullimi i ujësjellësit dhe kanalizimit në rrugët "NATO 99"	46.522
Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010	Shuma (euro)
Asfaltimi i rrugës fshatin Përlepnic	57.408
Rregullimi i ujësjellësit në fshatin Pasjan	48.770
Asfaltimi i rrugës Gumnisht e Epërme -Gumnisht e Poshtme	90.728
Asfaltimi i rrugës lagjen e Balcit	22.847
Asfaltimi i rrugës ne Fshatin Malishevë e Ulet	186.041
Asfaltimi i rrugës Fshatin Livoq i Poshtëm	55.104
Asfaltimi i rrugës ne lagjen "Zabeli"	30.446
Asfaltimi i rrugës ne fshatin Cernic -rruga e Bllacve	48.515
Asfaltimi i rrugës ne fshatin Velekinc	216.246
Ujësjellësi ne fshatin Llovc	39.071

5. Aktivitetet e Prokurimit Publik

Prokurimin publik, Komuna e Gjilanit e ka të rregulluar në nivel të zyrës e cila funksionon brenda Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme. Kjo zyre ka gjithsej pesë persona të punësuar.

Gjatë një viti kjo zyre shpall deri në 200 tenderë nga fusha e investimeve kapitale dhe në disa raste nga linja e buxhetit për mallra dhe shërbime. Për tri vite, Komuna e Gjilanit ka lidhur 499 kontrata përmes prokurimit publik.

Tabela nr.9: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Gjilanit 2010 -2012

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (euro)
2010	202	8.266.006,98
2011	171	6.122.138,86
2012	126	7.273.672,44
Totali	499	21.661.818,28

Gjatë viteve 2010-2012 dhe në katër muajt e parë të 2013, 25 operatorë ekonomik janë ankuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP) ndaj Komunës së Gjilanit. Në krahasim me komunat tjera, Gjilani është komuna ndaj së cilës më së shumti janë parashtruar ankesa në OSHP.

Tabela nr.10: Ankesat në OSHP ndaj Komunës së Gjilanit sipas viteve

Viti	2010	2011	2012	2013 (prill)	Totali
Numri i ankesave	9	6	6	4	25

Nga gjithsej 25 ankesa, dy prej tyre janë pezulluar gjatë fazës së shqyrtimit. Në 15 raste të tjera OSHP ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, si autoritet kontraktues, nuk i ka respektuar rregullat e parapara të prokurimit. OSHP i ka kthyer disa raste në ritenderim dhe disa të tjera në ri-vlerësim. Në tetë raste të tjera OSHP i ka dhënë të drejtë Komunës së Gjilanit.¹⁷

OSHP, në dy raste, njëra gjatë 2010 ndërsa një tjetër gjatë vitit 2012 ka nxjerrë urdhëresa të posaçme për Komunën e Gjilani nga e cila ka kërkuar që të respektojë vendimet e saj, apo në të kundërtën do të gjobitet komuna me të holla dhe do të kërkohej përjashtim nga puna e zyrtarit të prokurimit publik në Komunën e Gjilanit. Këto urdhëresa janë

¹⁷ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura për Komunën e Gjilani. 2010. 2011. 2012. 2013. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>

lëshuar pasi autoritetet e Gjilanit kanë refuzuar t'i përfillin vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit.¹⁸

Kryetari i Komunës së Gjilanit hetohet nga organet e rendit për përfshirjen e tij në dhënien e të drejtës për ndërtimin e objektit afarist banesor në qendër të Gjilanit kompanisë “Ari Trading”.¹⁹ Ky ndërtim është nisur në formën e partneritetit publiko - privat. Kompania “Ari Trading” i takon familjareve të cilëve Kryetari i Gjilanit u ka borxh 80.000 euro të cilën e ka deklaruar në formularin për deklarimin e pasurisë në Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit.²⁰

Janë hasur disa raste kur autoritetet komunale në Gjilan kanë kontraktuar punë me operatoret privat, kryerja e të cilave do të duhej të bëhej nga vetë zyrtarët komunal. Së paku në dy raste, Komuna e Gjilanit nuk do të duhej të shpallte tender por t'i përfundojë punët me stafin që ka. Kësisoj, Komuna e Gjilanit i ka dhënë 9.610 euro për studimin e nevojave të klubeve sportive në komunë.²¹ Dhënia e këtyre parave dhe veçmas arsyetimi për dhënien e tyre është paradoksal, ngase nevojat e klubeve sportive në vend (edhe në Gjilan) janë përgjithësisht të njohura dhe “studimi” i kësaj problematike do të duhet të bëhej nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe jo duke kontraktuar një kompani private me kosto shtesë. Në 2012, Komuna i ka dhënë tender në vlerë prej 7.800 eurosh “Foto Farit” nga Gjilani, për blerjen e fotografive për arkivimin e aktiviteteve të Komunës së Gjilanit. Një punë e tillë do të duhej të kryhej nga Zyra për Informim dhe arkivi i Komunës së Gjilanit.

Kryetari i Komunës së Gjilanit është përfshirë në përzgjedhjen e kompanisë e cila do të bënte transportimin e nxënësve të shkollave të mesme për në ekskursion në Shqipëri. Kryetari Mustafa u ka telefonuar drejtorëve të shkollave duke kërkuar nga ata favorizimin e kompanisë “Albatros” dhe “Sharr Travel” për bartjen e nxënësve. Kjo është pranuar edhe nga vetë Kryetari i cili ndërhyrjen e tij e ka arsyetuar më qellim të rritjes së sigurisë së udhëtimit për nxënësit.²² Lidhur me eskursionet për në Shqipëri, parregullsi ka gjetur edhe Auditorit i Përgjithshëm. Sipas raportit të ZAP, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjilanit ka paguar ndaj kompanisë “Merkatori” faturën në vlerën 2.048 euro për transport dhe akomodim të 32 punonjësve të komunës

¹⁸ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Urdhëresa 333/12. Datë 17.12.2012. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2012/Mirembajtja-e-rruges-ne-dy-lote.pdf> dhe urdhëresa 125/10.

Datë 06.07.2010. Burimi: http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2010/urdh_furnzmatkorrik10.pdf

¹⁹ Agjencia e lajmeve “Telegraf”. 25.06.2012. Qemajl Mustafa hetohet për tender. Burimi: <http://www.telegrafi.com/lajme/qemajl-mustafa-hetohet-per-tendere-2-23328.html>

²⁰ Agjencia Kundër Korrupsionit. Deklarimi i Pasurisë. Komuna e Gjilanit. Qemajl Mustafa. 2012. Burimi: http://akk-ks.org/2012/Komunat/Komuna_e_Gjilanit/Qemajl_Mustafa.pdf

²¹ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Komuna e Gjilanit. 2011. Burimi: <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=VieëNotices&ID=55052>.

²² Gazeta “Jeta në Kosovë”. Tetor 2012. Autor: Petrit Kryeziu dhe Jeton Musliu. Ekskursione keqpërdorimesh. Burimi: <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,3341>

për dy ditë në Durrës të Shqipërisë. Përveç faturës së shpenzimit dhe biletave të udhëtimit nga “Merkatori”, nuk ka ndonjë dëshmi shtesë që vërteton pjesëmarrjen e punonjësve në këtë eskurzion.²³

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa, gjatë vitit 2011 ka vetë deklaruar para të marra në bankat e vendit dhe nga personat privat në vlerë prej 250.000 euro. Ajo që bie në sy në këtë rast është zotimi i tij ndaj bankave dhe personave privat për t'i kthyer paratë në kohëzgjatje prej 4 vitesh.²⁴

Qemajl Mustafa del të këtë fshehur një pjesë të pasurisë së tij në deklarimin e pasurisë ndaj Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK). Kësisoj, gjatë vitit 2010 Qemajl Mustafa i ka deklaruar AKK, përveç tjerave, se posedon dy parcela toke, njëra në Gjilan dhe tjetra në Prishtinë në madhësi totale prej 3100 metrave katror, parcela këto të përfituara (blera) gjatë periudhës së paraluftës. Dy vite më pas, më 2012, Kryetari i Gjilanit i deklaroi AKK-së se posedon tri parcela toke në madhësi prej 11.300 metra katrorë, apo 8.200 metër katror me shumë se deklarimi gjatë vitit 2010. Të gjitha parcelat e tokës të deklaruara në vitin 2012 potencohen të jenë fituar (blerë) para periudhës së luftës.²⁵

Zyrtarisht kreu i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa, ka deklaruar në Agjencinë Kundër Korrupsionit se është aksionar me 250.000 euro vlerë, apo 15 për qind aksione, në kompaninë private “Viva Frutta”, e njohur si fabrika për përpunimin e bananeve në Gjilan. Në këtë kompani aksionar është edhe Mustafë Shala. Po ashtu, kreu i komunës Mustafa ka deklaruar se është aksionar me 10 mijë euro, apo me 50 për qind të aksioneve edhe në kompaninë “Vision” në Gjilan. Ortaku i Qemajl Mustafa në “Viva Frutta”, Mustafë Shala udhëheq edhe me kompaninë “Kompakt Grup”. Kjo kompani (“Kompakt Grup”) del të këtë marr tender në Komunën e Gjilanit në së paku gjashtë raste gjatë dy viteve të kaluara (2010-2012).²⁶

²³ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Gjilanit për vitin 2011. Fq 16 & 17. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGL_2011_Shqip_115733.pdf

²⁴ Agjencia Kundër Korrupsionit. Deklarimi i Pasurisë. Komuna e Gjilanit. Qemajl Mustafa. 2012. Burimi: http://akk-ks.org/2012/Komunat/Komuna_e_Gjilanit/Qemajl_Mustafa.pdf

²⁵ Agjencia Kundër Korrupsionit. Deklarimi i Pasurisë. Komuna e Gjilanit. Qemajl Mustafa. 2012. Burimi: http://akk-ks.org/2012/Komunat/Komuna_e_Gjilanit/Qemajl_Mustafa.pdf dhe deklarimi gjatë vitit 2010. Burimi: http://akk-ks.org/2010/Komunat_e_Republikes_se_Kosoves/Gjilan/2010_Qemajl%20Mustafa%20-%20Kryetar%20i%20Komunes%20Gjilane.pdf

²⁶ Komuna e Gjilanit. Raporti i punës së Drejtorive komunale për vitin 2012. Zyra e Prokurimit. Aktivitetet e Zyrës së Prokurimit për vitin 2012. Fq 2. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Assembly/Reports.aspx>

6. Administrata e Komunës së Gjilanit

Komuna e Gjilanit ka gjithsej 336 persona të punësuar në administratën komunale. Ndërsa së bashku me sektorin e arsimit, ku përfshihen të punësuarit në çerdhen e qytetit, në shkollat fillore dhe ato të mesme si dhe në sektorin e shëndetësisë, numri i të punësuarve në institucionet publike komunale është 2.745 persona.

Gjilani është një ndër komunat me administratën më të ngarkuar me shërbyes civil. Në rast se do të respektohej një vendim i Qeverisë së Kosovës i 3 dhjetorit 2008²⁷, Gjilani do të duhej të largonte nga puna rreth 200 shërbyes civil.²⁸ Si pasojë e mbingarkesës së stafit me shërbyes civil dhe tejkalimin e limitit për kategorinë e pagave, në gusht 2011, Ministria e Financave kishte bllokuar për disa javë lëshimin e fondeve për Komunën e Gjilanit. Numri i shërbyesve civil në Komunën e Gjilanit ka shkuar duke u rritur nga 269 shërbyes civil sa ka qenë më 2008 në 336 më 2012.²⁹ Kjo rritje e stafit ka ardhur përkundër vërejtjeve të shumta për mbingarkesë të stafit dhe përkundër asaj se disa shërbime janë privatizuar (siç është pastrimi dhe sigurimi fizik i objekteve).

Përveç, mbingarkesës së administratës me shërbyes civil, pagat e të cilëve paguhen nga kategoria e “pagave dhe mëditjeve”, Komuna e Gjilanit ka të punësuar edhe një numër të konsiderueshëm të punonjësve me “kontratë mbi vepër”, pagat e të cilëve paguhen prej kategorisë së “mallrave dhe shërbimeve”. Zakonisht personat e angazhuar me kontratë mbi vepër punësohen pa konkurs dhe nuk figurojnë në listën e të punësuarve dhe në listën e pagave. Punësimi i personave me kontratë mbi vepër nuk ka bazë ligjore as në bazë të Ligjit të ri për Shërbimin Civil.³⁰ Në këtë formë, Komuna e Gjilanit, më 2010, ka punësuar 7 punonjës, më 2011 ka punësuar 25 punonjës dhe më 2012 ka punësuar 38 punonjës me kontratë mbi vepër. Ajo çfarë bie në sy nga të dhënat të cilat i ka siguruar GAP, në bazë të kërkesës për qasje në dokumente publike, në Komunën e Gjilanit ka persona të punësuar me kontratë mbi vepër për më shumë se tri vite tani.

²⁷ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/46 i datës 03.12.2008. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_46-te_te_Qeverise_2008.pdf

²⁸ Instituti GAP. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe ndikimi i tyre në politikat publike, Tetor 2012, fq.6-7. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/67092_GAPanalizepertedhenateASK.pdf

²⁹ Sipas të dhënave të siguruar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil, në Ministrinë e Administratës Publike.

³⁰ Ligji nr.03/L-149 për Shërbimin Civil. Burimi: [http://gazetazyrtare.rks.gov.net/Documents/Ligji%20per%20sherbimin%20civil%20\(shqip\).pdf](http://gazetazyrtare.rks.gov.net/Documents/Ligji%20per%20sherbimin%20civil%20(shqip).pdf)

Tabela nr.11: Lista e të angazhuarve me kontratë mbi vepër nga Komuna e Gjilanit në periudhën 2010 - 2012

Nr.	Emri dhe Mbiemri i personit të angazhuar	Drejtoria përgjegjëse për angazhim	Pozita e punës të kryer nga personi i angazhuar më kontratë mbi vepër	Periudha e angazhimit (Data e fillimit dhe mbarimit të kontratës)
1	Afrim Salihu	Drejtoria e Inspektionit	Inspektor i Transportit	21.07.2010-31.08.2012
2	Armend Misini	Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport	Zyrtar në sektor të Sportit	20.10.2010-31.08.2012
3	Florim Demi	Drejtoria e Administratës	Zyra për Shërbim të Qytetareve	01.12.2010-31.08.2012
4	Mentor Mehovci	Drejtoria e Inspektionit	Inspektor i Transportit	21.07.2010- 31.08.2012
5	Srboljub Maksimovic	Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport	Mirëmbajtës i Stadiumit	Shtator – dhjetor 2010 & Janar – gusht 2012
6	Selvete Rahimi	Drejtoria e Administratës	Zyra e Gjendjes Civile	Dhjetor – 2010 Janar – gusht 2012
7	Shefqet Dauti	Drejtoria për buxhet dhe financa	Anketues-Regjistrues Prone	01.09.2010- 31.08.2012
8	Etrit Berisha	Inspeksion	Zyrtar i veterinarisë	01.03.2011- 31.08.2012
9	Fatos Rizahu	Drejtoria e Administratës	Asistent ne Bibliotekën Ligjore	01.03.2011- 31.08.2012
10	Galip Hiseni	Zyra për Komunitete dhe Kthim	Vozitës ne Zyrën për Komunitete dhe Kthim	01.03.2011- 31.08.2012
11	Habim Arifi	Kulturë, Rini Sport	Bibliotekist	01.03.2011- 31.08.2012
12	Zoran Simonovic	Zyra për Komunitete dhe Kthim	Shef i Zyrës për komunitete dhe Kthim	01.03.2011-31.08.2012
13	Urosh Arsic	Zyra për Komunitete dhe Kthim	Zyrtar për zhvillim dhe integrim ne ZKK	01.03.2011- 31.08.2012
14	Miroslav Kostiq	Zyra për Komunitete dhe Kthim	Zyrtar për Komunitet dhe Kthim	01.03.2011- 31.08.2012
15	Sabit Shala	Zyra e Kryetarit	Ndihmës i Mirëmbajtësit	01.04.2011- 31.08.2012
16	Flamur Bajrami	Drejtoria për Buxhet Financa	Anketues -Regjistrues Prone	13.04.2011-31.08.2012
17	Myrvete Mahalla	Drejtoria e Administratës	Zyrtare e Gjendjes Civile	20.04.2011-31.08.2012
18	Ramiz Isufi	Inspeksion	Zyrtar për ambient	26.04.2011-31.08.2012

			dhe evidentimin e deponive ilegale	
19	Fadil Jaha	Drejtoria e Inspeksion	Zyrtar ekzekutues	16.06.2011- 31.08.2012
20	Mirjeta Bllaca	Drejtoria e Administratës	Zyrtare e Gjendjes Civile	20.06.2011-31.08.2012
21	Valbona Mustafa	Zyra e Kryetarit	Zyrtar për personel	01.07.2011-31.08.2012
22	Fitore Gashi	Drejtoria e Inspeksion	Ins. e Sh.Publike - Ambient	19.07.2011- 31.08.2012
23	Isuf Morina	Drejtoria për Kulture	Mirëmbajtës i Stadiumit	17.08.2011- 31.08.2012
24	Abdulla Sylja	Drejtoria për Kulture	Mirëmbajtës i Stadiumit	17.08.2011- 31.08.2012
25	Remzi Kqiku	Drejtoria e Shëndetësisë	Zyrtar për koordinim me shoqatat për persona me aftësi të kufizuara	27.09.2011- 31.08.2012
26	Kushtrim Kadriu	Drejtoria për Kulture	Përgjegjës i sallës në Qytetit	03.10.2011-31.08.2012
27	Jehona Berisha	Partneritet publiko privat	Zyrtare Koordinatore ne PPP	01.12.2011- 31.08.2012
28	Bashkim Mustafa	Drejtoria e Inspeksionit	Ndihmës i Ndërtimit	01.01.2012-20.08.2012
29	Valmira Kryeziu	Drejtoria e Gjeodezisë	Zyrtare Financiare	01.02.2012-31.08.2012
30	Hava Ymeri	Drejtoria e urbanizimit	Arkitekte	01.02.2012-31.08.2012
31	Naim Ejupi	Drejtoria e Inspeksionit	Ekspedues	01.02.2012-31.08.2012
32	Donika Gjinolli	Drejtoria e urbanizimit	Zyrtar për planifikim te infrastrukturës	13.02.2012-17.08.2012
33	Hamdi Maliqi	Drejtoria e urbanizimit	Mirëmbajtës	01.03.2012-31.08.2012
34	Mentor Arifi	Drejtoria e Gjeodezisë	Teknik i Gjeodezisë	01.03.2012-31.08.2012
35	Aferdita Huruglica	Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për buxhet dhe Financa	Zyrtare Juridike	08.03.2012-31.08.2012
36	Hidajete Jashari	Drejtoria për buxhet dhe financa	Koordinator për qendrën e buxhetit	03.04.2012-31.08.2012
37	Naim Azemi	Zyra e Kryetarit	Vozitës	26.04.2012-29.08.2012
38	Admir Musliu	Drejtoria e Q.P.S	Mirëmbajtës i nxehjes qendrore	15.12.2012-31.12.2012

Në këtë formë, me kontratë mbi vepër, pa procedurë të konkursit, është pranuar në punë Valbona Mustafa - gruaja e vllaut të kryetarit Qemajl Mustafa. Valbona Mustafa është angazhuar në Zyrën e Kryetarit të Komunës si Zyrtare e Personelit.

Në komunë është punësuar edhe Perihane Mustafa - gruaja e Kryetarit të Komunës. Ajo është angazhuar në Drejtorinë e Arsimit. Ky veprim i Kryetarit të komunës pati ngjallur reagime të ndryshme duke përfshirë edhe protesta.³¹

7. Arsimi në Komunën e Gjilanit

Komuna e Gjilanit ka tri çerdhe publike, 44 shkolla fillore dhe nëntë shkolla të mesme.³²

Tabela nr.12: Numri i mësimdhënësve dhe stafit përcjellës në 44 shkollat fillore dhe nëntë shkolla të mesme të Gjilanit:

Gjinia	Shkolla fillore		Shkolla të mesme	
	Mësimdhënës	Stafi ndihmës	Mësimdhënës	Stafi ndihmës
Femra	642	74	193	21
Meshkuj	588	180	323	90
Gjithsej	1.230	254	516	111

Komuna e Gjilanit, investimet në arsim, gjatë tri viteve të kaluara, i ka fokusuar kryesisht në riparimin e objekteve, investimet në zgjerimin e hapësirave përmes ndërtimit të anekseve shkollore si dhe gëlqerosjes. Gjatë kësaj periudhe janë ndërtuar tri shkolla të reja, përkatësisht ajo në zonën e quajtur “Kodra e Dëshmoreve”, në fshatin Zhegër, dhe objektin e ri të gjimnazit “Zenel Hajdini”. Financimi i ndërtimit të këtyre shkollave mbi 80% ka qenë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Janë evidentuar keqpërdorime të shumta me rastin e përzgjedhjes së personelit arsimor në shkollat e Komunës së Gjilanit, sidomos në vitin shkollor 2011/12. Kandidatët të cilët nuk kanë arrit të hyjnë në listat e personelit mësimdhënës dhe partitë opozitare kritikojnë qeverisjen lokale për politizim të arsimit. N. Latifi, profesor i edukatës fizike nuk ka arrit të mbajë vendin e tij të punës (sipas tij pasi që ishte pjesë e LDK) dhe në vend të tij është zgjedhur F. Jashari, me gjashtë muaj përvojë pune dhe simpatizant i

³¹ Agjencia e lajmeve ‘Koha’. Datë 27.02.2013. Burimi: <http://www.kohaditore.com/?page=1,13,136705>

³² Numri i objekteve shkollore është llogaritur duke i përfshirë edhe paralelet e ndara. Realisht Komuna e Gjilani i ka 25 shkolla fillore me plus 19 paralele të ndara dhe po ashtu kjo komunë ka shtatë shkolla të mesme me plus dy paralele të ndara.

PDK-së.³³ Anëtari i komisionit intervistues, Nagip Krasniqi, ka pranuar në punë në shkollën fillore “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Livoç i Ulët nipin e vet, Elbasan Krasniqi, me përvojë pune gjashtëmujore dhe me notë mesatare 7.68 e nuk është pranuar mësimdhënësja Shqipe Haliti me përvojë të punës dyvjeçare dhe me notë mesatare 7.77. Edhe z. Krasniqi është nga PDK.³⁴ Ish drejtori i Arsimit Iljaz Kurteshi, tani Kryetar i degës së Vetëvendosjes në Gjilan, ka akuzuar Qemajl Mustafën se në mandatin qeverisës 2007-2009 ka tentuar të bëjë presion tek ai për pranim të kandidatëve në punë, përkundër mos pranimit të kriterëve. Sipas tij, ky presion ndaj Drejtorit të Arsimit po vazhdon edhe në këtë mandat (2009-2013). Menjëherë pas publikimit të listës së mësimdhënësve të pranuar për vitin shkollor 2011/12, Drejtori i Arsimit kishte dhënë dorëheqje, por dorëheqja e tij nuk ishte pranuar nga Kryesia e PDK-së në Gjilan.³⁵

Në përgjithësi, rregulli dhe disiplina në skollat e Gjilanit mungojnë. Janë të shpeshta zënkat në objektet e shkollës në mes nxënësve dhe mësimdhënësve. Një skandal i mos disiplinës në shkollën “Thimi Mitko” është publikuar në media në prill 2013.³⁶

8. Transparenca dhe informimi rreth aktivitetëve të Komunës së Gjilanit

Komuna e Gjilanit gjatë tri viteve të fundit (2010-2012) ka përmirësuar dukshëm nivelin e transparencës komunale. Ueb faqja zyrtare e Komunës posedon materiale dhe informata të shumëllojshme për shumicën e sferave që mbulon Komuna dhe po ashtu janë të publikuara edhe raportet financiare të këtij institucioni, si në lëminë e të hyrave ashtu edhe në atë të shpenzimeve të parasë publike. E kënaqshme ka qenë edhe përgjigja e Komunës në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumentet publike.

Po ashtu vlerësohet e kënaqshme edhe sasia e informatave që korrespondentët e medieve të shkuara marrin nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun. Media qendrore elektronike (RTK, KTV dhe RTV21) bëjnë pasqyrime të shpeshta nga kjo komunë dhe pasqyrimet e hasura janë kryesisht të natyrës së qeverisjes lokale. Pasqyrime të detajuara për zhvillimet në komunë bëjnë mediat e shkruara si “Koha Ditore”, “Zëri” “Tribuna” “Kosova Sot”. Këto media mbulojnë gjerësisht zhvillimet e përditshme në Komunën e Gjilanit si dhe pasqyrojnë kohë pas kohe problematikat e ndryshme në këtë komunë. Ajo çfarë e karakterizon Komunën e Gjilanit në krahasim me komunat tjera

³³ Edona Musa. Partizanët e Shkollave. 3 tetor 2011. Gazeta “Jeta në Kosovë”. Burimi:

<http://gazetajnk.com/?cid=1,979,170>

³⁴ Po aty.

³⁵ Po aty.

³⁶ <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=56814>

është edhe ekzistenca e dy portaleve të lajmeve mjaft të lexuara, e të cilat kryesisht mbulojnë aktivitetet e Komunës së Gjilanit dhe të komunave përreth.³⁷

Tabela: nr.13: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Gjilanit

<http://kk.rks-gov.net/gjilan/>

Dokumenti	2010				2011				2012			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	√	x	x	x	√	x	√	x	√
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	√	x	√	x	√	x	√	x	√
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	√	√	x	x	√	√	x	√	√
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	√	x	x	x	√	√	x	x	√
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	x	x	x	√	x	x	x	√	√	x	√	√
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	√	x	x	x	√	√	x	√	√
Drejtorja për Buxhet dhe Financa	x	√	x	√	√	x	√	x	√	x	√	√
Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër	x	x	x	√	x	x	x	√	√	x	x	√
Drejtorja për Shërbime Publike	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	√	x
Planifikim dhe Urbanizëm	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	x	√
Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	√	x	x	x	√	√	x	x	√
Drejtorja e Bujqësisë	x	x	x	√	x	x	x	√	√	√	x	√
Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim	x	x	x	√	x	x	x	√	√	x	x	√
Drejtorja për Zhvillim Ekonomik	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	√	√
Zyra e Prokurimit			√				√				√	
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm			x				x				x	
Procesverbalet e Kuvendit Komunal			√				√				√	
Rregulloret Komunale			√				√				√	
Vendimet e Kuvendit Komunal			√				√				√	
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal							√					
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës							√					

X = mungon raporti.

√ = raporti është i publikuar në ueb-faqe.

³⁷ Portalet www.2lonline.com dhe www.rajonipress.com

9. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009 kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z.Qemajl Mustafa, para elektoratit të tij ka shpalosur premtime në sfera të ndryshme. Pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në fund të vitit 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit iu përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizimin e tyre.

Tabela e mëposhtme vlerëson progresin e arritur në realizimin e premtimeve të dhëna në vitin 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 25 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas tri viteve të qeverisjes në Komunën e Gjilanit, 8 premtime janë përbushur, 12 tjera nuk janë përbushur, ndërsa në 5 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen akoma premtime të përbushura.

Premtimet e 2009	Realizimi 2010-2013
Krijimin e 4.000 vendeve të punës dhe paga më të larta (punësimin e më shumë se 1.000 personave në secilin vit)	Një premtim i pa përbushur. Komuna e Gjilanit është një nga komunat më të ngarkuara me staf në administratë, shëndetësi dhe arsim (gjithsej 2.745). Në sektorin privat Kryetari nuk mund të ndikojë në punësim. Përkundër taksave dhe tatimeve të ulëta komunale, biznesi nuk ka arrit të zhvillohet në masën e dëshiruar. Kohëve të fundit, kompani të mëdha kosovare kanë hapur degët e tyre në Gjilan (siç janë ETC, qendra tregtare "Viva Fresh", qendra tregtare "InterEx", "Gorenje", etj.), të cilat punësojnë më së shumti 50 persona, por të gjitha këto janë ndërmarrje shëbryese.
Përmirësimin e tregut të gjelbër, dhe krijimin e kushteve më të mira për shitësit.	Ende nuk është bërë asgjë konkrete në këtë drejtim. Premtim i pa përbushur.
Investimet në bujqësi me vlerë mbi 6 milionë euro	Ky premtim është gjysmë i realizuar në gjysmën e mandatit qeverisës. Sipas një broshure të publikuar nga Komuna e Gjilanit për investimet kapitale 2008-2011, del se që nga 2008 e deri në fund të 2011 në bujqësi janë investuar 4.6 milion euro. Kurse vetëm për vitet 2010-11 janë investuar 3.5 milion euro. Vërehet një rritje e konsiderueshme e investimeve në bujqësi nga viti 2008 (kur në këtë sektor ishin shpenzuar vetëm 392.223 euro), në vitin 2011 (kur janë investuar 2.260.294 euro).

<p>Investimet në industri, ndërtimtari dhe turizëm</p>	<p>Nuk ekziston asnjë investim në industri. Komuna nuk mund të investojë direkt në industri, por as nuk ka pasur iniciativa private për të investuar në këtë fushë.</p> <p>As në sektorin e ndërtimtarisë komuna nuk mund të investojë direkt. Si një ndikim indirekt në zhvillimin e kësaj fushe ndoshta mund të konsiderohen projektet e Partneritetit Publiko Privat, me anë të së cilave u mundësohet kompanive ndërtimore që të ndërtojnë në bashkëpunim me komunën në tokë publike komunale.</p> <p>Në fushën e turizmit nuk ka pasur ndonjë investim. Komuna e Gjilanit ka pak vende turistike. Si një nga pikat më të njohura turistike në këtë komunë është Kalaja e Pogragjës, por në të cilën nuk janë bërë investime që të tërheqin turistë. Para dy viteve, komuna ka filluar ndërtimin e Sahat Kullës në afërsi të stacionit të autobusëve. Ndërtimi i Sahat Kullës është zvarrit për shumë kohë dhe për momentin për rreth këtij monumenti në ndërtim e sipër është shndërruar deponi e mbeturinave. Të shumtë janë ata qytetarë të Gjilanit të cilët mendojnë se ndërtimi i Sahat kullës është një investim i panevojshëm, ngase ka kaluar koha e Sahat Kullave. Premtim pjesërisht i përmbushur.</p>
<p>Krijimin e kushteve më të mira për rritjen e investimeve të huaja dhe vendore</p>	<p>Përkundër asaj se Komuna e Gjilanit ka ulur tarifatat komunale për bizneset, duke u krijuar kushte të favorshme bizneseve të reja dhe duke liruar nga taksat bizneset prodhuese, prapë se prapë kjo komunë nuk ka arritur që të sjell investime të huaja dhe vendore. Biznesi vendor ka investuar në këtë komunë në tri vitet e fundit në përmasa relativisht të gjera. Premtim pjesërisht i përmbushur.</p>
<p>Ndërtimin e parkut industrial prej dhjetëra hektarëve, ku investitorët e brendshëm dhe të jashtëm do të kenë mundësi të investojnë</p>	<p>Premtim i pa realizuar. Komuna e Gjilanit nuk ka hapësirë publike për ndërtimin e një parku të tillë. Në 2011, është arritur një marrëveshje me Komunën e Novobërdës që në territorin e kësaj të fundit, saktësisht në fshatin Llabjan, të ndërtohet një park biznesi (zonë ekonomike). Mirëpo planet kanë mbetur përzgjysmë, në mungesë të mbështetjes financiare nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe mungesës së mjeteve për të komisionuar studimin e fizibilitetit për këtë zonë.</p>

Ndarjen e një pjese të madhe të buxhetit për OJQ-të	Kryetari i Komunës përmes vendimeve të tij ekzekutive ka ndihmuar disa OJQ (shoqata), siç është Shoqata Ndër komunale e të Verbërve dhe me të Pamë të dobësuar (ndihmë me derivate 30 litra në muaj). Është mbështetur financiarisht "Handikos"-i si dhe nëpërmjet linjës së buxhetit për subvencione janë përkrahur individë dhe organizata të ndryshme. Premtim i përmbushur.
Hapjen e shkollave të reja dhe reformimin e shkollave ekzistuese	Premtim i përmbushur. Janë ndërtuar tri shkolla të reja dhe janë riparuar një numër shkollash tjera.
Mundësimin e mbarëvajtjes së praktikës për studentët	Premtim i pa përmbushur.
Ndërtimin e objektit të ri për administratën dhe kuvendin	Premtim i pa realizuar. Planet për ndërtimin e një objekti të ri komunal kanë dështuar. Zotimi i mjeteve nga Komisioni Evropian për të ndërtuar një objekt të ri administrativ për Komunën e Gjilanit ka dështuar. Planet kanë qenë që në vendin ku ndodhet objekti aktual i gjykatës të ndërtohet objekt i ri i Komunës. Me qëllim që mjetet e zotuar të Komisionit Evropian të mos ri destinohen në ndonjë komunë tjetër, Komuna e Gjilanit ka kërkuar që me ato mjete të ndërtohet Biblioteka e qytetit. Administrata komunale e Gjilanit është e shpërndarë në 6 objekte të ndryshme nëpër qytet, të cilat kryesisht nuk i plotësojnë kushtet për punë.
Investimet e dukshme ne lagjen " Arbëria "	Premtim i përmbushur. Ka pasur investime të gjera në këtë zonë.
Investime në energjetikë, ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara, parkingje, unazën transitore, ndërtimin e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit, trajtim të mbeturinave dhe ujërave të zeza	Për gjitha këto fusha ka pasur investime dhe përpjekje të konsiderueshme nga ana e autoriteteve lokale. Por, problemet në të gjitha këto fusha mbesin evidente. Premtim i përmbushur.
Pastrimi i ujërave të zeza në gjithë fshatrat e mëdha dhe pastaj trajtimin e tyre në një fabrikë	Premtim i pa realizuar.
Përfundimin e projektit për pastrimin e lumit Mirusha	Projekti ka filluar por akoma nuk ka përfunduar. Deri në fund të këtij viti planifikohet përfundimi i tij. Premtim i përmbushur.
Realizimin e projektit për trajtimin e lumit Stanishor	Asgjë nuk është bërë në këtë drejtim. Lumi Stanishor i cili shtrihet në dalje të qytetit, në drejtim të rrugës së Malishevës , kundërmon dhe është kanal i hapur i ujërave të zeza. Premtim i pa përmbushur.

Ndërtimin e një qendre multi-kulturore, ku do të vendosen të gjitha grupet rinore, teatrale dramatike, muzikore, figurative, dhe ku do të ketë hapësirë të mjaftueshme, si dhe kushte ideale për punë dhe aktivitete rinore e kulturore	Ekziston një plan për ndërtimin e një qendre të tillë përballë Hotel Kristal në Gjilan, mirëpo deri më tani asgjë konkrete nuk është ndërmarrë në këtë drejtim. Premtim i pa përmbushur.
Renovimin e teatrit	Premtim i pa përmbushur.
Mbështetje për Qendrën socio-kulturore "Don Bosko"	Komuna ka ndihmuar qendrën "Don Bosko" që të zgjidh problemin e pronës ku zhvillon aktivitetet kjo qendër. Premtim i përmbushur.
Ndërtimin e bibliotekës së re	Me ndihmën financiare të Komisionit Evropian ka filluar ndërtimi i Bibliotekës së qytetit, në vendin ku më parë ka qenë ndërtesa e ish TMK-së.
Ndërtimin e një parku me një qendër rekreative sportive, në hapësirën e zbrazët që dikur ishte treg i kafshëve	Premtim i pa përmbushur.
Investime në terrene sportive, stadione dhe palestra	Komuna është duke ndërtuar një fushë ndihmëse sportive mbrapa Palestrës së Sporteve. Disa herë komuna ka investuar në stadiumin kryesor të qytetit, duke financuar për ndërrimin e barit dhe rregullimin e fushës. Tek Palestra e Sporteve përkundër instalimit të ngrohjes disa vite më parë, gjatë dimrit në këtë palestër temperaturat janë gjithnjë të ulëta. Premtim i pjesërisht i përmbushur.
Ndërtesë të re për QKMF-në	Nuk është investuar në ndërtesë të re të QKMF Premtim i pa përmbushur.
Investime në ndërtimin e shtëpisë për të moshuarit	Premtim i pa përmbushur.
Krijimin e planeve rregulluese;	Komuna ka hartuar planet rregulluese për lagjen "Fidanishtë", për "Kodra e Thatë". Tani së fundmi është hapur diskutim publik për planet rregulluese të lagjeve "Dheu i Bardhë" dhe "Baja". Premtim i përmbushur.

10. Burimet

1. Komuna e Gjilanit. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Raporti analitik i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2010. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Assembly/Reports.aspx>
2. Komuna e Gjilanit. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Raporti analitik i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Assembly/Reports.aspx>
3. Komuna e Gjilanit. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Raporti analitik i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2012. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Assembly/Reports.aspx>
4. Komuna e Gjilanit. Zyra e Kryetarit. Raporti i punës për periudhën janar – dhjetor 2012. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Assembly/Reports.aspx>
5. Raportet vjetore 2010 dhe 2011 të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu_OpenNode=90
6. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për vitin 2011 për Komunën e Gjilanit. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGL_2011_Shqip_115733.pdf
7. Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura për Komunën e Gjilanit. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>
8. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf
9. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: http://ëëë.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf
10. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e raundit të dytë të rezultateve për zgjedhjet lokale të vitit 2009. Burimi: http://www.kqz-ks.org/SKQZ-ËEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/rezultatetkk_raundi%202.pdf
11. Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011.
12. Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2012.
13. Qeveria e Kosovës. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
14. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: http://ëëë.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf
15. Agjencia Kundër Korrupsionit. Deklarimi i Pasurisë. Komuna e Gjilanit. Qemajl Mustafa. 2011. Burimi: http://akk-ks.org/2011/Komunat_e_Kosoves/Komuna_Gjilan/Qemajl_Mustafa.pdf
16. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Vetëqeverisje lokale. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf

17. Agjencia Kundër Korrupsionit. Vendimet për konflikt të interesit. Qemajl Mustafa. Vendim i nxjerr me 14.05.2012. Nr.03-1793/2012. Burimi: <http://akk-ks.org/repository/docs/03-1793-2012.pdf>
18. Qeveria e Kosovës. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor. Departamenti i ujërave. Investimet. Burimi: <http://mmph-rks.org/sq/Departamenti-i-Ujërave/304>
19. Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura për Komunën e Gjilani. 2010. 2011. 2012. 2013. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>
20. Komuna e Gjilanit. Faqja zyrtare në internet. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjilan/>